



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:189143

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05310482

C.nr.466/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jashar Gashi, me bashkëpunëtoren profesionale Selvije Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Xh.... M....., A.... P....., Gj.... F...., A... G...., Sh.... M..... dhe A..... M....., që të gjithë nga K...., të cilët sipas autorizimit përfaqësohen nga avokatët F.... G.... dhe K.... F....., nga Prishtina me adresë Rr.“F....A....”, nr.25/4, kundër të paditurës K... e K....- D..... K..... e A....., me objekt kontesti, Pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, pagesa e shujtave ditore dhe kompensim në emër të kualifikimit-licencimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.02.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësit A.....G, nga K....

II.DETYROHET e paditura K. e K. – D..... K..... e A....., që paditësit A.... G...., në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit të i'a paguajë shumën prejeuro, për periudhën kohore nga data 26.08.2018 deri me datën 24.06.2022, gjithsejtë për 671 ditë pune, me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 25.08.2021, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, si dhe shpenzimet e procedurës në emër të padisë, për precizimin e padisë 104 euro dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20 euro apo shumën e përgjithshme prej 124.00 euro e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve Xh.. M....., A.... P....., Gj... F....., Sh.... M.... dhe A..... M.....

ARSYETIM

Paditësit, përmes te autorizuarve të tyre me padi të parashtruar pranë kësaj gjykate më datën 25.08.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës K....e K....., me bazë ligjore pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, pagesa për shujta ditore dhe kompensim në emër të kualifikimit-licencimit.

Me parashtrësën e datës 08.12.2023, i autorizuari i paditësve ka theksuar se me anë të kësaj parashtrëse e tërheq padinë për paditësit Xh....M..... A..... P....., Gj..... F....., Sh..... M..... dhe A.... M....., për të gjitha kërkesat si në padi, po ashtu për paditësin A..... G....., është tërhequr nga padia për kërkesën sa i përket shujtës, ngase të njëjtën e ka filluar e paditura në mënyrë vullnetare të ju paguaj, si dhe për kërkesën për kompensim në emër të kualifikimit/gradimit, për shkak se për të njëjtën kërkesë ka iniciuar padi përmes një avokati tjetër. Tutje i autorizuari i paditësit, ka bërë zgjerimin dhe precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv lidhur me kërkesën për kompensim në emër të shpenzimeve të udhëtimit duke hequr dorë nga pjesa e parashtruar ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura K.... e K.....- D..... K.... e A....., që paditësit A.... G....., në emër të kompensimit të pagesës së biletës së udhëtimit prej 70% të vlerës së biletës për periudhën 26.08.2018 e deri me datën 20.09.2021, për relacionin K.... –G.... të ia paguajë për 750 ditë pune 70% të vlerës së biletës së udhëtimit, e që i bie sipas vlerësimit çmimi i biletës për dy drejtimet është në vlerë prej 1.40 euro ($1.40 \cdot 70\% = 0.98\text{€}$) $0.98 \cdot 750 \text{ ditë} = 735.00 \text{ €}$, ndërsa për periudhën 20.09.2021 e deri me datë 21.11.2022, për relacionin K....-U....., të ia paguajë për 308 ditë pune 70% të vlerës së biletës së udhëtimit, e që i bie sipas vlerësimit çmimi i biletës për dy drejtimet është në vlerë prej 2.60 euro ($2.60 \cdot 70\% = 1.82\text{€}$) $1.82 \cdot 308 \text{ ditë} = 560.56\text{€}$, që i bje gjithsej në total shumën prej 1,295.56 euro me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë 25.08.2021, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë, në emër të taksës gjyqësore dhe në emër të precizimit të padisë.

E paditura Komuna e Klinës, me anë të përgjigjes në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, si të pa bazuar, për shkak të mos ekzistimit të bazës juridike dhe ligjore dhe vlerës së lartëcekur. E paditura ka theksuar se as K... e K... e as DKA-ja në K..., nuk janë nënshkruese të kontratës së tillë kolektive të lëmisë së arsimit, madje punëdhënësi Komuna

e K.... dhe DKA-ja saj nuk e kanë të nënshkruar as kontratën kolektive adekuate të nivelit lokal siç e parasheh dispozita e nenit 90 par 2 të Ligjit të punës, pra K.... e K.... si dhe DKA-ja, përmes Organizatës sindikale të arsimit nuk e kanë të lidhur dhe nënshkruar një kontratë të tillë në nivel ndërmarrjeje apo si punëdhënës, krejt kjo do të thotë se në rastin konkret DKA-ja e Komunës së K...., në cilësinë e punëdhënësit në njërën anë dhe Organizata Sindikale komuna e arsimit, në anën tjetër nuk kanë të lidhur kontratë të tillë kolektive në kuadër të ndërmarrjes-lemisë së arsimit, prandaj e paditura nuk mund të merr përsipër kurrfarë detyrimesh të tilla të pa kontraktuara si këto pretenduese të paditësve. Po ashtu i autorizuari i të paditurës ka theksuar se Ministria e Financave nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimet e udhëtimit. Sa i përket jashtëafatshmërisë së padisë dhe kërkesës së saj në rastin konkret pala paditëse nuk i ka shterur mjetet interne të kërkesës dhe pretendimeve lëndore apriori tek punëdhënësi për të realizuar pastaj procedimin e rregullt dhe të afatshëm ligjor tek gjykata kompetente dhe se kjo padi tani konsiderohet e parakohshme në njërën anë e po ashtu edhe e jashtafatshme në anën tjetër ngase është paraqitur te gjykata pas kalimit të çdo afati të mundshëm ligjor krejt kjo nëse merret parasysh periudha kohore e kërkesës pretenduese në raport me vetë kohën e inicimit të kontestit gjyqësor dhe paraqitjen e padisë në gjykatë. Në fund ka propozuar që në cilësi të dëshmitares të dëgjohet përfaqësuesi kompetent nga DKA, zyrtarja e pagesave M..... B....., për sqarimin e rrethanave relevante për argumentimin e gjendjes faktike dhe çështjes së shujtave dhe shpenzimet e udhëtimit e po ashtu që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të saj, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SH.F.M.U “Z....”, në fshatin G... K... e K...., e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të kontratës së punës së paditësit me numër të protokollit 112-5108/2017 e datës 19.09.2017, dhe në vërtetimet me numër protokollit 371/2023 i datës 24.11.2023 dhe 125/2023 i datës 20.11.2023.

Gjykata përmes vërtetimeve të lëshuar nga ana e të paditurës mbi ditët e prezencës në punë, të paditësi, ka vërtetuar faktin se paditësi A... G....., për periudhën kohore nga data 26.08.2018 deri

me datën 20.09.2021, ka qenë prezent në punë 750 ditë pune në SHFMU “Zgjimi” G.... ndërsa nga data 20.09.2021 deri me datën 21.11.2022, ka 308 ditë pune në SHFMU “A. K.”, në fshatin U.... K... e K..., për të cilat kërkon kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Gjykata nga vërtetimi i lëshuar nga Agjensia e udhëtimit “A. T.”, me datë 20.11.2023, për paditësin A... G..., ka vërtetuar faktin se i njëjti udhëton për çdo ditë të punës në relacionin K...-G.... dhe anasjelltas dhe çmimi i biletës për dy drejtimet është në vlerë prej 1.40 euro, kurse nga vërtetimi i datës 20.11.2023, vërtetohet fakti se paditësi udhëton për çdo ditë të punës në relacion Klinë-Ujmirë, dhe anasjelltas dhe çmimi i biletës për dy drejtimet është në vlerë prej 2.60 euro.

Kontratat e punës dhe vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e lëshuara nga ana e SH.F.M.U “Z...”, në fshatin G..., K.... e K..., dhe SH.F.M.U “A.... K....”, në fshatin U.... K.... e K....., si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësit, kështu gjykata këtyre provave i’au fali besimin e plotë.

Po ashtu në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1, thuhet “ Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë), qendrat burimore në kuadër të MASHT-it dhe qendrat e kompetencës në kuadër të AAAPARR), shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBAShK-ut”. Ndërsa në dispozitën e nenit 3 të kësaj kontrate në pikën nën 2 sqarohet termi i, e punësuar ku do të thotë “punëtor ose punëtore, i/e cili/cila, ka lidhur marrëdhënie pune për kohë të caktuar, apo të pacaktuar, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, të Marrëveshjes Kolektive, në nivel të vendit dhe të kësaj Kontrate me nenin 35 par.7, të KKAK-së është paraparë se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet*

arsimore” kurse me paragrafi 5, të po këtij neni është paraparë se “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”. Vlera e kompensimit të shujtave ditore është 2 (dy) euro për një ditë pune kurse për shpenzimet e udhëtimit, për një ditë pune, është 70% të biletës së udhëtimit.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit të cilët kanë cilësinë e mësimdhënësve pranë të paditurës, t’ia paguaj kompensimin për shujtat ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësin, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, gjykata për shpenzimet e udhëtimit i ka shumëzuar me shumën 70 % të çmimit të biletës së udhëtimit të parapara si në nenin 35 paragrafi 5 të KKAK-së, duke ia njohur paditësit Gashi, shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, për çka vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykim kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ndërsa shumën e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet përpilimit të padisë, për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 104 € dhe për taksën gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, apo shumën e tërësishme të tyre prej 124.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS - DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.466/21, më datën 09.02.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale:

Selvije Morina

Gjyqtari:

Jashar Gashi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.